



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
SH.A."PARKU UDHETAREVE SHKODER "
Asambleja e Pergjithshme e Aksionereve

VERTETOHET NJESIA
ME ORIGINALIN
DREJTORI PETRIT STEFA
DATE 21/01/2016



V E N D I M
Nr. 02, Date 05.11. 2012.

I Asamblese te Pergjithshme te Aksionereve te SH.A."P.U.SH "

Ne zbatim te Ligjit Nr.9901, date 14.04.2008, "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare" dhe Statutit te kesaj shoqerie, Asambleja e Pergjithshme e Aksionereve te SH.A."Parku Udhetareve Shkoder", e mbledhur me daten 05.11.2012, ora 10.00, ne seline e shoqerise, zhvilloi mbledhjen e saj me rend dite :

- 1) Raporti i drejtorise te shoqerise mbi veprimtarine ekonomiko-financiare te SH.A."Parku Udhetareve Shkoder", per periudhen janar-gusht, te v. 2012".
- 2) Miratimin e bilancit financiar te shoqerise per periudhen janar – gusht, te v.2012 , te SH.A."Parku Udhetareve Shkoder".
- 3) Miratimin e vleresimit te asetave te luajtshme dhe te paluajtshme te SH.A."Parku Udhetareve Shkoder" , nga specialiste te licensuar.
- 4) Fillimi i procedurave te shitjes te asetave te kesaj shoqerie, ne zbatim te Ligjit Nr.9901, date 14.04.2008, "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare" ,neni 201.
- 5) Miratimin e fillimit te procedurave te likujdimit te sh.a.,likujduesit te SH.A."Parku Udhetareve Shkoder" dhe struktures perkatese ne zbatim te Statutit te kesaj shoqerie dhe Ligjit Nr.9901, date 14.04.2008, nenit 191, duke filluar nga dt.01.09.2012.
- 6) Kerkeses te sindikates te punonjesve te parkut per shitjen e mjeteve, makinerive, paisje ,etj, ne radhe te pare punonjesve te parkut.
- 7) Kerkeses te aksionereve privat per perdorimin e truallit te SH.A."Parku Udhetareve Shkoder" si shesh ndertimi per pallate banimi dhe perfitimi sipas pjesmarrjes ne kapital, 60 % Bashkia Shkoder dhe 40 % aksioneret privat.
- 8) Te ndryshme.

Pasi u lexuan dhe u diskutuan te gjitha pikat e rendit te dites, ne perfundim te diskutimeve, Asambleja e Pergjithshme e Aksionereve te SH.A."Parku Udhetareve Shkoder", me unanimitet te plote :

V E N D O S I :

- 1) MIRATIMIN e raportit te drejtorise mbi veprimtarine e shoqerise gjate periudhes janar- gusht, v.2012.
- 2) MIRATIMIN e bilancit financiar te shoqerise per periudhen janar –gusht , v.2012.

3) MIRATIMIN e raportit te vleresimit te aseteve te luajtshme dhe te paluajtshme te sh.a. "Parku Udhetareve Shkoder", te hartuar nga ekspertet e miratuar.

4) MIRATIMIN e fillimit te procedurave te shitjes te aseteve te luajtshme te sh.a. Parku Udhetareve Shkoder", sipas procedurave ligjore per kete qellim, por duke pasur parasysh edhe kerkesat e punonjesve te parkut.

Te ardhurat nga shitja e aseteve te luajtshme te sh.a., ne zbatim te Ligjit Nr.9901, date 14.04.2008, neni 201 do te perdoren per pagesen e borxheve te shoqerise, ne fillim Sigurimet Shoqerore te punonjesve te parkut.

Bashkia Shkoder, si aksioneri kryesor i kesaj shoqerie duhet te zbatoje plotesisht Vendimin e Keshillit Bashkiak Shkoder Nr.107, date 30.11.2007, duke i dhene parkut vleren e mbetur prej 3 379 616 leke, me te cilen duhet te paguhen vetem Sigurimet Shoqerore te punonjesve te parkut, ne radhe te pare punonjesve qe dalin ne pension.

5) MIRATIMIN e prishjes te sh.a. "Parku Udhetareve Shkoder" dhe hapjen rruge te fillimit te procedurave te likujdimit te kesaj shoqerie. Grupi i emeruar per procesin e likujdimit te shoqerise dote jete :

- Petrit Stefo likujdator
- Albana Celiku ek. Finance
- Kimete Hysa mag.-arke.
- Sokol Elezi roje parku
- Edmond Ndou roje parku
- Paulin Gjollaj roje parku
- Kastriot Elezi roje parku

Niveli i pagave te tyre eshte percaktuar ne Vendimin e Keshillit Mbikqyres Nr. 03, date 31.08.2012.

6) PER KERKESEN e sindikates te parkut ,qe ne shitjen e mjeteve te transportit, makinerive, paisjeve, etj, ne radhe te pare te jene punonjesit e parkut, te gjitha aksioneret ne parim jane dakort, por kjo duhet te realizohet duke zbatuar legjislacionin ne fuqi.

7) KERKESA e aksionereve privat per perdorimin e truallit si shesh ndertimi per pallate ndertimi dhe perfitimi sipas pjesmarrjes ne kapital : 60 % Bashkia Shkoder dhe 40 % aksioneret privat, do te jete pjese e nje studimi ekonomiko financiar me prespektive per zhvillimin e ketij trualli.

Per hipotekimin perfundimtar te truallit te shoqerise, ku Bashkia Shkoder ka 60 % pjesmarrje ne kapital, (perfshi edhe truallin) dhe aksioneret privat kane 40 % pjesmarrje ne kapital, (perfshi edhe truallin), ne bashkepunim dhe me ndihmen e juristeve te Bashkise Shkoder do te kalohet ne proces gjyqsor.

Per Asamblene e Pergjithshme te Aksionereve te sh.a. "P.U.SH"

SEKRETARE

(Kimete Hysa)

KRYETARE

(Flora Petri)

Shkoder, me 05.11.2012.